



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 28 dhjetor 2021
Nr.ref.:RK 1929/21

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI177/20

Parashtrues

Sinan Shehu

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
Supreme të Kosovës, Rev. nr. 227/2020, të 6 korrikut 2020**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Gresa Caka-Nimani, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është Sinan Shehu, nga Komuna e Kamenicës.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i fundit i kontestuar është Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 227/2020, i 6 korrikut 2020, i cili përmes poste i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 6 tetor 2020.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston Aktvendimin [Rev. nr. 227/2020] e 6 korrikut 2020 të Gjykatës Supreme, me pretendimin se ky Aktvendim i shkel të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që identiteti i tij të mos zbulohet për arsye personale.

Baza juridike

5. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

6. Më 13 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
7. Më 30 nëntor 2020, Kryetarja e Gjykatës me vendim, caktoi gjyqtarin Nexhmi Rexhepi gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama Hajrizi, Gresa Caka Nimani dhe Safet Hoxha.
8. Më 3 dhjetor 2020, Gjykata njoftoi parashtruesin e kërkesës për regjistrimin e kërkesës dhe Gjykatës Supreme i dërgoi një kopje të kërkesës.
9. Më 3 dhjetor 2020, Gjykata i kërkoi informata Gjykatës Themelore në Gjilan për të konfirmuar datën e pranimit të Aktvendimit të kontestuar të Gjykatës Supreme nga parashtruesi i kërkesës.
10. Më 18 dhjetor 2020, Gjykata Themelore në Gjilan informoi Gjykatën se Aktvendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 6 tetor 2020.
11. Me 17 maj 2021, bazuar në paragrafin 5 të nenit 114 [Përbërja dhe Mandati i Gjykatës Kushtetuese] të Kushtetutës dhe rregullit 12 (Zgjedhja e Kryetarit dhe 2 e Zëvendëskryetarit) të Rregullores së punës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani u zgjodh Kryetare e Gjykatës Kushtetuese. Bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit të Gjykatës KK-SP 71-2/21, u përcaktua që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani, detyrën e Kryetares së Gjykatës e merr pas

përfundimit të mandatit të Kryetares aktuale të Gjykatës Arta Rama-Hajrizi, me 26 qershor 2021.

12. Më 25 maj 2021, bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 9 (Përfundimi i mandatit para kohës) të Ligjit dhe Rregullit 7 (Dorëheqja e gjyqtarëve) të Rregullores së Punës, Gjyqtari Bekim Sejdiu paraqiti dorëheqjen e tij nga pozita e gjyqtarit pranë Gjykatës Kushtetuese.
13. Me 31 maj 2021, Kryetarja e Gjykatës, Arta Rama-Hajrizi, me Vendimin nr. KK 160/21 përcaktoi që gjyqtarja Gresa Caka-Nimani të caktohej kryesuese e Kolegjeve shqyrtuese në rastet në të cilët ajo ishte caktuar anëtare e Kolegjit, përfshirë edhe rastin aktual.
14. Më 26 qershor 2021, bazuar në paragrafin (4) të rregullit 12 të Rregullores së punës dhe Vendimit KK-SP 71-2/21, të 17 majit 2021 të Gjykatës, gjyqtarja Gresa Caka-Nimani mori detyrën e Kryetares së Gjykatës, ndërsa bazuar në pikën 1.1 të paragrafit 1 të nenit 8 (Përfundimi i mandatit) të Ligjit, Kryetarja Arta Rama-Hajrizi përfundoi mandatin e Kryetares dhe të gjyqtares së Gjykatës Kushtetuese.
15. Më 28 qershor 2021, Kryetarja e Gjykatës, Gresa Caka Nimani, përmes Vendimit KSH 177/20, emëroi gjyqtaren Remzie Istrefi-Peci si anëtare të Kolegjit shqyrtues në vend të gjyqtares Arta Rama Hajrizi.
16. Më 10 dhjetor 2021, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

17. Në bazë të shkresave të rastit, rrethanat faktike kanë të bëjnë me një kontest pronësor, respektivisht pronësinë dhe mënyrën e fitimit të saj mbi ngastrën kadastrale [00768-1] dhe më pas me ndarjen e trashëgimisë në mes parashtruesit të kërkesës dhe vëllait të tij Xh.Sh., si dhe motrës së tij S.M.
18. Më 28 janar 2009, motra e parashtruesit të kërkesës S.M., kishte lidhur kontratë për dhurim [Vr. 162/09] të ngastrës kadastrale [00768-1] vëllait të saj Xh.Sh., të cilën ajo e kishte fituar në bazë të një vendimi gjyqësor, si rezultat i kontestit gjyqësor mes një pale tjetër R.S., dhe jo në bazë të trashëgimisë.
19. Më 11 shkurt 2013, parashtruesi i kërkesës paraqiti padi kundër S.M., dhe Xh.Sh., për anulimin e kontratës për dhurim të [Vr. 162/09] të 28 janarit 2009, me arsyetimin se i është cenuar e drejta e pronësisë me bazë trashëgimie nga i ati M.Sh. Parashtruesi i kërkesës poashtu kërkoi që të vërtetohet se ai është pronar i gjysmës së ngastrës kadastrale [00768-1] duke pretenduar se i takon pronësia në bazë të trashëgimisë nga i ati M.Sh.
20. Më 12 janar 2015, Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, përmes Aktgjykimit [C.nr.37/2013] refuzoi padinë e parashtruesit të kërkesës si të pabazuar, me arsyetimin se nuk është cenuar e drejta e pronësisë së parashtruesit të kërkesës pasi që ngastra kadashtale gjatë hapjes së trashëgimisë

nuk ishte e evidentuar në emër të M. Sh., (babait të palëve ndërgjyqësore) dhe se kjo ngastër ishte fituar me vonë përmes një vendimi gjyqësor nga ana e S.M.

21. Në një datë të paspecifikuar, parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale.
22. Më 30 gusht 2019, Gjykata e Apelit përmes Aktgjykimit [Ac.nr.1537/15] refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore.
23. Gjykata e Apelit ndër të tjera arsyetoj "*[...] S.M., e ka fituar te drejtën e pronësisë ne ngastrën kontestuese me vendim gjyqësore e jo në bazë të trashëgimisë siç edhe vërehet nga aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Kamenicë C.nr.64/78, i cili është administruar si provë dhe gjendet në shkresat e lëndës. Nga ky aktgjykimi provohet fakti se ngastra kadastralka qenë e regjistruar në emër te R.S.,dhe në bazë të vendimit gjyqësore për kontestin e zhvilluar, e të cekur me lartë, ngastra ka kaluar ne pronësi të këtu paditurës S.M. Nga kjo rezulton se ngastra kadastrale kontestuese nuk ka qene objekt shqyrtimi i trashëgimisë se bëre pas vdekjes se te ndjerit M..Sh., ngase kjo ngastër kadastrale në momentin kur është bere trashëgimia ka qenë e evidentuar në emër te R.S., nga Hogoshti dhe pas vdekjes se të ndjerit M.Sh., kjo ngastër nuk figuron ne aktvendimin mbi trashëgimin T.nr.36/76*".
24. Më 18 nëntor 2020, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme, me pretendimin për shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.
25. Më 6 korrik 2020, Gjykata Supreme përmes Aktvendimit [Rev.nr.227/2020] hodhi poshtë si të palejuar revizionin, për shkak të vlerës së kontestit, duke arsyetuar se parashtruesi i kërkesës kishte paraqitur vlerën e kontestit dukshëm më të vogël se sa vlera e lejuar për ngritjen e kërkesës për revizion.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e rregullta me vendimet e tyre kanë shkelur të drejtat e tij, duke pretenduar se: "*Në bazë të nenit 113.7 te Kushtetutës se Republikës se Kosovës, si dhe neneve: 46, 47, 48, 49 dhe 50, të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës se Kosovës. Gjykata Themelore në Gjilan, Dega në Kamenicë, provat materiale nuk i ka shtjellua fare, Gjykata Apelit të Kosovës në Prishtinë, ankesën kundër aktgjykimit fare se ka analizuar po ashtu Gjykata Supreme e Kosove në Prishtinë, revizionin e ushtruar sipas kësaj çështje juridike, nuk e ka shqyrtuar fare, çka neve nuk kemi koment lidhur me veprimet e gjykatave*".
27. Parashtruesi i kërkesës thekson: "*E paditura e dyte S.M., ka qenë e mashtruar dhe e kërcënuar nga i padituri i pare Xh.Sh., nga Gjilani, rr." Vllazrit Frashri " nr. 55, ku ai e ka detyruar të Noteri Fatmir Halimi nga Gjilani, të përpilon deklaratën të rrejshme me datë 08.01.2014 në prezencën e dëshmitar*".

28. Parashtruesi në kërkesën e tij, përveç që referohet në Kushtetutë, nuk specifikon e as nuk qartëson se cilat të drejta dhe liri dhe në çfarë mënyre i janë cenuar ato përmes aktit të autoritetit publik të cilin ai e konteston.
29. Përfundimisht, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që: (i) kërkesën e tij të shpallë të pranueshme; (ii) të shpallë të paligjshëm dhe të pabazuar vendimin e kontestuar, përkatësisht Aktvendimin [Rev. nr. 227/2020] e 6 korrikut 2020 të Gjykatës Supreme, në lidhje me Aktgjykimin [Ac.nr.1537/15] e 30 gushtit 2019 të Gjykatës se Apelit dhe Aktgjykimit [C.nr.37/2013] e 12 janarit 2015, të Gjykatës Themelore, duke e kthyer çështjen në rivendosje; dhe (iii) kërkon moszbulimin e identitetit të tij.

Pranueshmëria e kërkesës

30. Për të gjykuar mbi kërkesën e parashtruesit të kërkesës, Gjykata paraprakisht vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe të specifikuar më tej me Rregullore të punës.
31. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili parasheh:
- “Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”*
32. Në vazhdim, Gjykata shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata u referohet neneve 47 [Kërkesa individuale], 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

*Neni 47
[Kërkesa individuale]*

- 1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.*
- 2. Individ i mund ta ngritë kërkesën në fjalë vetëm pasi që të këtë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*

*Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]*

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

*Neni 49
[Afatet]*

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor [...]”

33. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kushteve, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në cilësinë e palës së autorizuar, duke kontestuar një akt të një autoriteti publik, përkatësisht Aktvendimin [Rev.nr.227/2020] të Gjykatës Supreme të Kosovës, të 6 korrikut 2020, pas shterimit të të gjitha mjeteve juridike të përcaktuara me ligj. Në këtë aspekt, kërkesa e parashtruesit të kërkesës është në përputhshmëri me kriteret e përcaktuara me paragrafin 1 dhe 7 të nenit 113 të Kushtetutës dhe nenin 47 të Ligjit. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu e ka dorëzuar kërkesën në pajtim me afatin e përcaktuar në nenin 49 të Ligjit.
34. Megjithatë, në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 48 të Ligjit, i cili përcakton detyrimin që në kërkesën e tij drejtuar Gjykatës parashtruesi i kërkesës duhet të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar me aktin e kontestuar të autoritetit publik.
35. I njëjti kriter është qartë i përcaktuar edhe në rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë] të Rregullores së punës. Rregulli 39, paragrafi (1) (d) përcakton:
 - (1) Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:
 - (d) kërkesa qartëson saktësisht dhe në mënyrë adekuate paraqet faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
36. Rrjedhimisht, Gjykata thekson se për të konsideruar që një kërkesë i plotëson kriteret e pranueshmërisë, parashtruesi i kërkesës është i detyruar që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe në mënyrë adekuate të paraqesë faktet dhe pretendimet për shkeljen e të drejtave apo dispozitave kushtetuese.
37. Kësisoj, Gjykata verën se parashtruesi i kërkesës nuk ka qartësuar se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar përmes aktit të kontestuar të autoritetit publik, përkatësisht Aktvendimit Rev. nr. 227/2020, të 6 korrikut 2020 të Gjykatës Supreme, të cilin ai e konteston në Gjykatë. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës nuk i qartëson saktësisht faktet dhe pretendimet për shkelje të të drejtave kushtetuese.
38. Në rrethanat e rastit konkret, përderisa kërkesa e parashtruesit të kërkesës, është në përputhshmëri me kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me nenin 1 dhe 7 të Kushtetutës dhe nenin 47 dhe 49 të Ligjit, e njëjta nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë siç janë përcaktuar me nenin 48 të Ligjit dhe pikën (d) të paragrafit (1) të rregullit 39 të Rregullores së punës.
39. Si përfundim, në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe me rregullin 39 (1) (d) të Rregullores, kërkesa është e pranueshme.

Kërkesa për moszbulimin e identitetit

40. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës kishte kërkuar që identiteti i tij të mos zbulohet publikisht, duke pretenduar se: *“Janë çështje të ngushta familjare”*.
41. Në këtë drejtim, Gjykata rikujton rregullin 32 (6) të Rregullores së punës, i cili përcakton *“Palët në kërkesë që nuk dëshirojnë që identiteti i tyre të zbulohet në publik, duhet të tregojnë arsyet që justifikojnë një largim të tillë...”*.
42. Duke u bazuar në arsyetimin e paraqitur nga parashtruesi i kërkesës, Gjykata konsideron se arsyetimi i dhënë nga ana e parashtruesit të kërkesës nuk paraqet argumente të mjaftueshme për miratimin e kësaj kërkesë (shih, përshtatshmërisht, rastet e Gjykatës Kushtetuese: rastin KI74/17, parashtrues *Lorenc Kolgjeraj*, Aktvendim për papranueshmëri i 5 dhjetorit 2017; rastin KI202/18, parashtrues *Ejup Qerimi*, Aktvendimi për papranueshmëri, i 27 marsit 2019, paragrafi 30).
43. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës nuk e ka arsyetuar kërkesën e tij për moszbulim të identitetit dhe rrjedhimisht të njëjtën e hedh poshtë si të pabazuar.


PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafët 1 dhe 7 të Kushtetutës, nenet 20 dhe 48 të Ligjit dhe rregullat 32 (6) dhe 39 (1) (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 10 dhjetor 2021, njëzëri

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TË REFUZOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit, dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Nexhmi Rexhepi



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Gresa Caka-Nimani